



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:003297
Datë: 24.12.2024
Numri i dokumentit: 06648085

C-IV-14-3305

Ankuesi

Korporata Energjetike e Kosovës - KEK, Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 24 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI013-0006, i datës 02 prill 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 prill 2014, ankuesi Korporata Energjetike e Kosovës (tutje KEK) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit me Nr. GJI013-0006, të datës 02 prill 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për faturat e papaguara, për energji elektrike të NSH “1 Maj” në likuidim, në shumë prej 2,097.32 Euro për periudhën e faturimit prej 05 shtator 2002 deri më 05 maj të vitit 2011. Ankuesi ka pohuar se në tërësi ka vepruar sipas udhëzimit të AKP-së duke parashtruar kërkesë brenda afatit të përcaktuar nga AKP-ja dhe duke ofruar të gjitha informatat dhe të dhënat që kanë të bëjnë me borxhin e NSH-së dhe se borxhi i kërkuar është me bazë ligjore dhe nuk është i parashkruar. Po ashtu ankuesi ka pohuar se AKP-ja nuk ka të drejtë që zyrtarisht të deklarohet në lidhje me parashkrimin edhe kur ai ekziston, pasi që është organ që e vendos çështjen dhe me këtë bie në kundërshtim me nenin 360 par. 3 të LMD-së, ku thuhet

se nuk mund të përfilllet zyrtarisht parashkrimi nga organi që e vendos çështjen nëse atë nuk e ka invokuar vet debitori.

Me 16 dhjetor 2024, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se bazuar në nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit Nr./L-034 për AKP dhe nenit 374 të Ligjit për Kontratat dhe detyrimet kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit të kërkesës, kur ndërmarrja nuk përmbushi detyrimet e saj. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL-së, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Në bazë të nenit 374 të Ligjit mbi Detyrimet, (botuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr. 29/1978, ligj i zbatueshëm në kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi), parashihet se “*Kërkesat e ndërsjella të personave juridik nga kontrata për tregtinë e mallrave dhe pretendimet për kompensimin e shpenzimeve të bëra në lidhje me këto kontrata vjetërsohen për tre vjet*”. Të njëjtin rregullim e parasheh edhe dispozita e nenit 355 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (Ligji Nr. 04/L-077, ligj i zbatueshëm në kohën e marrjes së këtij vendimi).

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të faturave të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e

saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me faturat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës, ankuesi kërkesën e ka parashtruar lidhur me faturat e pa paguara, për periudhën 05 shtator 2002 deri më 05 maj 2011, në shumë prej 2,097.32 Euro. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për faturat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 15 janar 2014, që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në likuidim, por në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore faturat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore, se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës pranë AL-së apo se është pohuar borxhi në ndonjë mënyrë, qoftë edhe nëpërmjet pagesës së ndonjë kësti, kështu do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100.00 Euro.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare